



**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

Duke marrë parasysh:

- Nenin 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6, Nenin 14 paragrafi 2 nënparagrafi 2.6, Nenin 25 dhe Nenin 43 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, Nr. 03/L-185;
- Rregullën për vendosjen e çmimeve të furnizuesit publik të energjisë elektrike (Rregulla për Çmimet e FPEE-së);
- Rregullën për vendosjen e çmimeve të gjenerimit (Rregulla për Çmimet e Gjenerimit);
- Rregullën për vendosjen e çmimeve të operatorit të sistemit të shpërndarjes (Rregulla për Çmimet e OSSH-së);
- Rregullën për vendosjen e çmimeve të operatorit të sistemit të transmisionit dhe të tregut (Rregulla për Çmimet e OST/OT-së);
- Aplikacionin e KEK sh.a. të dorëzuar në kuadër të Shqyrtimit të Gjashtë të Tarifave të Energjisë Elektrike(SHTE6);
- Aplikacionin e KOSTT sh.a. të dorëzuar në kuadër të Shqyrtimit të Gjashtë të Tarifave të Energjisë Elektrike(SHTE6);

**Në mbledhjen e mbajtur më 20 qershor 2012 nxori këtë:**

**VENDIM**

**APROVOHEN** tarifat me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët e rregulluar që do të zbatohen nga KEK-SH.A. nga data 1 qershor 2012.

**Arsyetim**

- I. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka pranuar nga Korporata Energjetike e Kosovës (KEK SH.A) aplikacionet për tarifa në kuadër të Shqyrtimit të Gjashtë të Tarifave të Energjisë Elektrike;
- II. Për vendosjen e tarifave me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët e rregulluar, ZRRE ka marrë parasysh dokumentet e lëshuara dhe të publikuara në ueb faqen e saj:
  - Shqyrtimi i gjashtë i tarifave të energjisë elektrike 2012 (SHTE6) – Raport konsultativ, KEK sh.a 2012; dhe
  - Shqyrtimi i gjashtë i tarifave të energjisë elektrike 2012 (SHTE6) – Përgjigjet ndaj komenteve.



- III. Duke marrë parasysh dhe duke u bazuar në dispozitat ligjore të theksuara më lartë dhe shqyrtimet e të gjitha shkresave dhe dokumenteve relevante, Bordi ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- IV. Struktura e tarifave me pakicë e energjisë elektrike për konsumatorët e rregulluar të KEK-SH.A., që do të zbatohen nga data 1 qershor 2012, është si në tabelën e mëposhtme.

Grupi Tarifor	Niveli i tensionit të furnizimit	Elementi Tarifor	Njësia	Koha gjatë ditës	SHTE6		
					Sezoni i Lartë	Sezoni i ulët	
					1 tetor - 31 mars	1 prill - 30 shtator	
0-1	220kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		182,53		
		Fuqia e angazhuar	€/kW/muaj		14,44		
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh		2,23		
0-2	110kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		91,27		
		Fuqia e angazhuar	€/kW/muaj		6,09	6,09	
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e Lartë	7,07	2,09	
			€/kWh	Tarifë e Ulët	2,94	1,72	
		Energjia reaktive (Q)	€/kVArh		0,00	0,00	
1	35kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		12,07		
		Fuqia e angazhuar	€/kW/muaj		6,33	6,33	
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e Lartë	7,39	3,20	
			€/kWh	Tarifë e Ulët	3,91	2,88	
		Energjia reaktive (Q)	€/kVArh		0,72	0,72	
2	10kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		4,99		
		Fuqia e angazhuar	€/kW/muaj		5,45	5,45	
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e Lartë	8,28	3,69	
			€/kWh	Tarifë e Ulët	4,46	3,36	
		Energjia reaktive (Q)	€/kVArh		0,72	0,72	
3	0.4 kV Kategoria I (konsumatorët e mëdhenj të energjisë reaktive)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		2,81		
		Fuqia e angazhuar	€/kW/muaj		3,17	3,17	
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e Lartë	9,20	5,11	
			€/kWh	Tarifë e Ulët	5,80	4,82	
		Energjia reaktive (Q)	€/kVArh		0,72	0,72	
4	0.4kV Kategoria II	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		3,18		
		Energjia aktive (P)	€/kWh	Tarifë e vetme	11,33	7,33	
			€/kWh	Tarifë e Lartë	13,64	8,94	
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e Ulët	6,82	4,46	
5	0.4kV matësi 2 tarifor (2-vlerësh, shtëpiak)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		2,27		
		Energjia aktive (P) për konsum:					
		<200kWh/muaj (Blloku i parë):	€/kWh	Tarifë e Lartë	5,05	3,63	
			€/kWh	Tarifë e Ulët	2,54	1,81	
		200-600kWh/muaj (Blloku i dytë):	€/kWh	Tarifë e Lartë	7,00	5,01	
			€/kWh	Tarifë e Ulët	3,51	2,51	
		>600 kWh/muaj (Blloku i Tretë):	€/kWh	Tarifë e Lartë	10,16	7,27	
€/kWh	Tarifë e Ulët		5,07	3,65			
6	0.4kV matësi 1 tarifor (1-vlerësh, shtëpiak)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		2,27		
		Energjia aktive (P) për konsum:					
		<200kWh/muaj (Blloku i parë):	€/kWh	Tarifë e vetme	4,51	3,22	
		200-600kWh/muaj (Blloku i dytë):	€/kWh	Tarifë e vetme	6,24	4,46	
		>600 kWh/muaj (Blloku i Tretë):	€/kWh	Tarifë e vetme	9,05	6,49	
7	0.4kV (shtëpiak pa matës)	Konsumi i vlerësuar:					
		<200 kWh/muaj	€/konsumator/muaj		23,41		
		200-600 kWh/muaj	€/konsumator/muaj		42,37		
		>600 kWh/muaj	€/konsumator/muaj		71,40		
8	Ndriçim publik	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		3,18		
		Energjia aktive (P) për konsum:	€/kWh	Tarifë e vetme	9,17	9,17	

Tarifa e lartë aplikohet prej orës 07:00 - 22:00 gjatë sezonit të lartë dhe prej orës 08:00 - 23:00 gjatë sezonit të ulët.  
Konsumatori ngarkohet me energji reaktive mbi atë të lejuarën që korrespondon me  $\cos(\Phi)=0.95$



- V. KEK SH.A. duhet ta publikojë këtë vendim në së paku një prej gazetave ditore me qarkullim të gjerë në Kosovë, brenda 5 ditësh të punës pas marrjes së vendimit nga ZRRE dhe publikimit të tij në faqen elektronike të saj.
- VI. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhje në mes të përkthimeve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- VII. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente, brenda katërmëdhjetë (14) ditëve, nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

#### **Bordi i ZRRE-së**

---

Enver Halimi, kryesues

---

Përparim Kabashi, anëtar

---

Blerim Koci, anëtar

---

Merita Kostari, anëtare

---

Krenar Bujupi, anëtar